



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 729 Akti**

**Nr. 775 Vendimi**  
**Tiranë, më 14.6.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 14.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Aneta Strakosha**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 18.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Alma Faskaj (Vokopola), si dhe u deklarua mospasja e asnjë konflikti interesi nga anëtarët e trupit gjykues.
5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Prosesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Prosesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Prosesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka dokumentacion të plotë ligjor për të ardhurat e deklaruara ndër vite;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e mbajtur për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**12.** KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar<sup>4</sup> rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të vlerësimit profesional të kryer, bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**13.** Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret: kontrolli i pasurisë, i figurës dhe profesional, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 4.6.2024, vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 4.6.2024 nëpërmjet adresës elektronike<sup>5</sup> në lidhje me rezultatet e hetimit, të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime, si dhe të kërkojë marrjen e provave të reja, duke i dhënë një afat të arsyeshëm deri në datën 11.6.2024.

<sup>1</sup> Akt kontrolli nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2018.

<sup>2</sup> Raporti për kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 7.7.2023, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha me nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2023.

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018.

<sup>5</sup> Nëpërmjet adresës elektronike me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, si dhe për të marrë kopje të saj elektronike në datën 7.6.2024. Në datën 11.6.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti pranë Komisionit<sup>6</sup> shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit.

**16.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë<sup>7</sup> subjektin në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë përmes postës elektronike në datën 11.6.2024.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**17.** Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 14.6.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

**18.** Subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**19.** Znj. Aneta Strakosha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**19.1** Subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha ka paraqitur prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**20.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**20.1** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, objektivitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**20.2** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

---

<sup>6</sup> Protokolluar me nr. \*\*\*, datë 11.6.2024.

<sup>7</sup> Me vendimin nr. 3, datë 11.6.2024, të trupit gjykues.

**20.3** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK -ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**20.4** Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**20.5** Por, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>8</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**20.6** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) dy deklaratat e pasurisë të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; (d) deklaratën para fillimit të detyrës si kancelare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, viti 2010, si dhe deklaratën e interesave pas largimit nga funksioni datë 5.10.2010; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe rezultatet e testimin pranë Shkollës së Magjistraturës; (ë) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (f) shpjegimet me shkrim gjatë procesit të hetimit dhe në përfundim, si dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**21.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

**21.1** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha.

---

<sup>8</sup> 41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se "procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

**21.2** Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

**22. Dyqan me sip. 31.2 m<sup>2</sup>, në Vlorë**, blerë në vitin 2012 nga shitësit H.S etj., sipas kontratës së shitjes<sup>9</sup> datë 29.3.2012. Vlera: 2,460,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

**22.1 Si burim krijimi** të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga puna si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë për periudhën qershor 2005 – tetor 2010; të ardhura nga puna e saj dhe e bashkëshortit si avokat për periudhën prill 2011 – qershor 2015*”.

### **Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri**

**22.2** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP Vlorë dhe nga DPPP-ja.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

**23.** Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.3.2012, nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. H.S, dhe vëllezërit e tij, J.S<sup>10</sup> etj., i shesin shtetasit A.S, bashkëshortit të subjektit, njësinë me sip. 31.2 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, kundrejt çmimit 2,460,000 lekë.

**23.1** Nga administrimi i akteve<sup>11</sup> në lidhje me origjinën e kësaj pasurie rezultoi se më parë pasuria është përfituar nga babai i bashkëshortit të subjektit, i ndjeri M.S , i cili me kontratën e shitjes “Për truallin sipërfaqe funksionale të objektit” i ka blerë Bashkisë Vlorë truallin me sip. 55 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 44,000 lekë.

**23.1.1** Më tej, mbi këtë truall, i ndjeri M.S ka ndërtuar një shtesë dyqani, ku me vendimin nr. \*\*\* , datë 31.10.2001, të KRRT Vlorë “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, është miratuar sheshi i ndërtimit me të dhënat: *destinacioni shtesë dyqani, i ndodhur në katin e parë të pallatit \*\*\* , në lagjen “\*\*\*\*”*.

**23.1.2** Me vendimin nr. \*\*\* , datë 12.12.2001, të KRRT Vlorë është lëshuar leja e ndërtimit, me subjekt ndërtues shoqëria “\*\*\*\*”, për ndërtimin e shtesës së dyqanit sipas kushteve të miratuara në këtë leje dhe me afat kohor deri më 20.2.2002 dhe, në vijim, është nxjerrë akti i kolaudimit<sup>12</sup>, me investitor M.S , për plotësimin e kushteve teknike dhe funksionale për shfrytëzim të dyqanit.

**23.2** Pasi shtetasi M.S ka ndërruar jetë, pasuria dyqan i ka kaluar me trashëgim bashkëshortes së tij, znj. H.S , dhe tre djemve, përfshirë edhe bashkëshortin e subjektit, të cilët e kanë gëzuar bashkërisht në pjesë takuese të barabarta.

**23.3** Pasuria është regjistruar në regjistrat publikë<sup>13</sup> të pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi të shtetasve H.S , A.S , J.S , V.S, R.S , E.S dhe E.S , duke gëzuar secili nga 1/7 pjesë takuese mbi këtë pasuri, përpara se t’i kalonte plotësisht bashkëshortit të subjektit.

<sup>9</sup> Nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

<sup>10</sup> Përfaqësuar me prokurë nga shtetasja H.S. Referuar deklaramit të subjektit në pyetësin 2 dhe certifikatës familjare, rezultat nga hetimi i Komisionit, shitësit e kësaj pasurie janë nëna dhe vëllezërit e bashkëshortit të subjektit.

<sup>11</sup> Shihni praktikën e ZVRPP Vlorë, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, pjesë e dosjes ILDKPKI.

<sup>12</sup> Datë s’ka.

<sup>13</sup>Referuar certifikatës për vërtetim pronësie datë 23.3.2012.

**23.4** Nga hetimi i Komisionit dhe nga vlerësimi i akteve të administruara në dosjen e hetimit nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

#### **Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga gëzimi i kësaj pasurie dhe hetimi i Komisionit**

**24.** Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se nga kjo pasuri ka realizuar të ardhura nga qiradhënia, përkatësisht: *për periudhën qershor 2015 – dhjetor 2015 në shumën 5,000 lekë/muaj, në total 35,000 lekë; për periudhën prill 2016 – dhjetor 2016 në shumën 8,000 lekë/muaj, në total 72,000 lekë.* Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ<sup>14</sup>, subjekti ka deklaruar se dyqani është dhënë me qira që nga viti 2011 dhe se në vitin 2017 nuk është dhënë më me qira për shkak të shkëputjes nga Vlora dhe pamundësisë së menaxhimit të tij. Në mbështetje të deklarimeve, subjekti ka paraqitur kontratat e qirasë, përkatësisht, kontratë qiraje e lidhur me datën 14.1.2015, midis bashkëshortit të subjektit dhe palës qiramarrëse, shtetases L.L, me afat kontrate 1-vjeçar, me vlerë qiraje 5,000 lekë/muaj, si dhe kontratë qiraje e lidhur me datën 1.4.2016 midis bashkëshortit të subjektit dhe palës qiramarrëse, shtetasit R.N, me afat kontrate deri më 4.1.2017, me vlerë qiraje 8,000 lekë/muaj.

**24.1** Më tej, pyetur nga Komisioni në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj, subjekti ka informuar Komisionin se qiramarrësit kanë qenë tregtarë dhe se i kanë paguar ato detyrimet tatimore, duke sqaruar konkretisht se për periudhën janar 2011- janar 2016 dyqani i është dhënë me qira shtetases L.L me aktivitet tregtar “Farmaci” dhe, në vijim, për periudhën prill 2016 – prill 2017 i është dhënë me qira shtetasit R.N , me aktivitet “Bar-kafe”.

**24.2** Në lidhje me provueshmërinë e pagesës së detyrimeve tatimore nga subjektet qiramarrëse, subjekti i rivlerësimit i ka sqaruar<sup>15</sup> Komisionit se ka bërë përpjekjet e saj për të marrë informacionin e kërkuar, porse nga ana e Drejtorisë së Tatimeve nuk i është dhënë informacioni pasi nuk është subjekt që legjitimohet të marrë informacion sipas ligjit, duke paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2024, të Drejtorisë Tatimore Dega Vlorë.

**24.3** Ndodhur në të tilla rrethana, Komisioni iu drejtua shkresërisht<sup>16</sup> Drejtorisë Tatimore Dega Vlorë, për t’u informuar nëse qiramarrësit kanë qenë të regjistruar për efekte tatimore, si dhe mbi pagesën e tatimit të mbajtur në burim, nga ku Drejtoria Tatimore Dega Vlorë<sup>17</sup> informon se qiramarrësit L.L dhe R.N kanë qenë të regjistruar si tatimpagues për efekte tatimore dhe kanë deklaruar tatim qiraje në adresën ku ndodhet dyqani dhe, konkretisht, për qiramarrësen L.L për vitin 2010 është deklaruar shuma 6,000 lekë, për vitin 2013 shuma 6,000 lekë, për vitin 2015 shuma 60,000 lekë dhe vetëm për muajin janar 2016 shuma 5,000 lekë; ndërsa për shtetasin R.N është deklaruar shuma 72,000 lekë për periudhën mars 2016 – 31.12.2016.

**24.4** Në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Tatimore Dega Vlorë, rezulton se totali i të ardhurave të ligjshme të përfituara nga qiraja për vitet 2010 – 2016 janë në shumën 217,000 lekë, të përfshira në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

<sup>14</sup> Në të dy pyetësorët kur është pyetur për të ardhurat nga qiraja.

<sup>15</sup> Shihni përgjigje të pyetjes 4 të pyetësorit 2.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2024, dhe kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2024 prot., në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2024.

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2024.

**25.** Komisioni, gjatë hetimit ka konsultuar legjislacionin në lidhje me vlerat minimale referuese të qirave për Rrethin Vlorë, ku sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 3.6.2015<sup>18</sup> “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, hyrë në fuqi më 15.6.2015, vlera minimale e qirasë për qytetin e Vlorës është 8,339 lekë/muaj<sup>19</sup> dhe për vitin 2016 është 8,676 lekë/muaj. Bazuar në vlerat referuese, Komisioni konstatoi se çmimi i qirasë, deklaruar nga subjekti për secilën periudhë, dukej relativisht i ulët e, për këtë qëllim, i kërkoi subjektit shpjegime.

**25.1** Subjekti ka shpjeguar së pari se pavarësisht se kontrata e qirasë është formalizuar në vitin 2015, marrëdhënia e qirasë ka nisur 10 vite më përpara me të njëjtën qiramarrëse kundrejt të njëjtës vlerë qiraje mujore prej 5,000 lekësh, e cila është menaxhuar nga vëllai i bashkëshortit të saj dhe së dyti kontrata e qirasë është formalizuar në janar të vitit 2015, pra përpara se të hyjë në fuqi vendimi i Këshilli të Ministrave e, në vijim, me rritjen e çmimit, qiramarrësja L.L nuk pranoi vazhdimin e marrëdhënies së qirasë dhe kështu në muajin prill të vitit 2016 dyqani i është dhënë me qira shtetasit R.N për një periudhë 1-vjeçare në shumën 8,000 lekë. Subjekti, gjithashtu, ka shtuar se dyqani ndodhet në periferi të qytetit ku ka lëvizje vetëm në gjysmën e ditës. Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti paraqiti në cilësinë e provës kontratë qiraje noteriale<sup>20</sup> datë 12.12.2005, lidhur midis shtetasit R.S , kunati<sup>21</sup> i subjektit dhe shtetas L.L , sipas së cilës provohet se vlera e rakorduar mes palëve në vitin 2005 ka qenë në shumën 5,000 lekë, pra aq sa është edhe në kontratën e qirasë për vitin 2015.

**25.2** Komisioni administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, sipas së cilës provohet se marrëdhënia e qirasë ka nisur herët me të njëjtën qiramarrëse, shtetasen L.L , kundrejt të njëjtit çmim, është rinovuar me të njëjtat kushte për një periudhë 10-vjeçare, kushte këto që tregojnë për një marrëdhënie të qëndrueshme, rënë dakord mes palëve dhe se provohet gjithashtu se kontrata e fundit e qirasë e datës 14.1.2015 në vlerën 5,000 lekë/muaj është rregulluar gjithashtu me vullnetin e palëve, pasi VKM-ja nr. 469/2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” nuk kishte hyrë ende në fuqi, ndërkohë kontratat e tjera të qirave kanë vijuar me një qira të përafërt me vlerën minimale referuese të qirave. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u konstatuan problematika.

### **Në lidhje me burimet e krijimit për blerjen e dyqanit dhe analiza financiare**

**26.** Subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar si burime krijimi të ardhurat nga puna si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë, për periudhën qershor 2005 – tetor 2010, të ardhura nga puna e saj dhe e bashkëshortit si avokat, për periudhën prill 2011 – qershor 2015.

**26.1** Komisioni ka hetuar në lidhje me të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur, si dhe ka analizuar dokumentacionin e siguruar gjatë hetimit administrativ, ku për efekt të analizës

<sup>18</sup> I cili përcakton se: “Për dhënie me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytete të tjera, vlera minimale e qirasë mujore, për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon: a) Për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, vlera minimale e qirasë mujore është 1.5 (një pikë pesë) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe të apartamenteve të banimit”.

<sup>19</sup>  $31.2 * 59,400 * 1.5 * 0.003 = 8,339$  lekë/muaj në vitin 2015 dhe  $31.2 * 61,800 * 1.5 * 0.003 = 8,676$  lekë/muaj në vitin 2016.

<sup>20</sup> Me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

<sup>21</sup> Verifikuar nga hetimi i Komisionit sipas informacionit të vënë në dispozicion nga DPGJC-ja me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 29.4.2024.



financiare janë konsideruar si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruara dhe mbi të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**26.2** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni me të ardhurat e deklaruara nga subjekti që nga qershori 2005 e deri në datën e blerjes së dyqanit, dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e dyqanit, duke rezultuar me balancë negative në shumën -1,543,294 lekë.

**26.3** Bazuar në këtë rezultat financiar, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**27.** Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare e, konkretisht, zërin e të ardhurave, duke pretenduar të ardhura më të larta; konkretisht të ardhura nga ushtrimi i profesionit që nga viti 2002, të mbështetura në vendime gjyqësore (76 copë) si përfaqësuese në gjykime për periudhën 2002 – 2004. Gjithashtu, ka kërkuar që për rillogaritjen e të ardhurave të konsiderohet një marzh më i lartë fitimi për këtë lloj aktiviteti, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, nga rivlerësimi i të cilit do të rezultonin të ardhura më të larta.

**27.1** Subjekti, gjithashtu ka kërkuar të konsiderohet edhe një depozitë prej 1,000,000 lekësh pranë Raiffeisen Bank, të cilën e ka disponuar dhe pastaj e ka tërhequr me dy *transhe* gjatë vitit 2011 në shumën 900,000 lekë, provuar nga akti nxjerrje llogarie datë 26.4.2024, lëshuar nga Raiffeisen Bank.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**28.** Trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit për përfshirje në analizë të të ardhurave të tjera nga avokatia, të përfituara për shkak të pjesëmarrjes si përfaqësuese në gjykata për periudhën 2002 – 2004 dhe vëren se në analizën financiare për blerjen e dyqanit janë përfshirë të gjitha të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur sipas deklaramentit të subjektit, të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën qershor 2005, kur subjekti ka marrë detyrën si kancelare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë e deri në datën e kryerjes së transaksionit të shitblerjes, datë 29.3.2012. Të ardhurat e tjera të pretenduara jashtë kësaj periudhe nuk mund të përfshihen në analizë, për sa nuk janë deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar si burime krijimi.

**28.1** Në lidhje me pretendimin e subjektit se ka pasur likuiditete të tjera në formë depozite bankare, të cilat janë tërhequr për t'u përdorur për blerjen e dyqanit në vitin 2012, trupi gjykues vëren se subjekti ka pasur depozitë pranë Raiffeisen Bank të krijuar në vitin 2008<sup>22</sup> dhe brenda shtatorit të vitit 2011 ka kryer tri tërheqje me një total prej 959,000 lekësh.

**28.2** Në deklaratën e vitit 2010 “para fillimit të detyrës” si dhe “pas largimit nga funksioni” si kancelare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti ka deklaruar “*Depozitë në Raiffeisen Bank në shumën 850,000 lekë, të depozituara në vitin 2009*”, ndërsa në vitin 2011 subjekti nuk ka pasur deklarament pasurie.

**28.3** Nga analiza financiare e kryer për të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personit të lidhur me të për vitin 2011, rezultoi një balancë pozitive në shumën 1.254,000 lekë. Referuar hetimit të Komisionit, për këtë vit nuk vërehen investime për blerje pasurish nga subjekti

---

<sup>22</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2021 prot., në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2022, si dhe shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2024 prot., në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2024.

dhe/apo personi i lidhur, përveç shpenzimeve jetike, si dhe shpenzimet e deklaruar/konstatuar nga Komisioni. Për rrjedhojë, balanca pozitive e evidentuar në fund të vitit 2011 mund të jetë mbartur në vitin pasardhës në formë kursimesh, të cilat mund të jenë përdorur nga subjekti dhe personi i lidhur për blerjen e dyqanit. Kjo qasje e trupës arrihet duke qenë se: (i) mungon deklarimi i kohës; (ii) vërehen likuiditete bankare të tërhequra gjatë vitit 2011<sup>23</sup>, të cilat nuk duken të jenë përdorur për investime në pasuri të tjera; (iii) pasuria është krijuar përpara marrjes së detyrës si subjekt rivlerësimi.

**28.4** Bazuar në këto fakte, trupi gjykues krijon bindjen se për blerjen e dyqanit në datën 29.3.2012, subjekti mund të ketë përdorur kursimet e mbartura nga viti 2011 në shumën 1.254,000 lekë. Nën këtë logjikë, u rishikua analiza financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e dyqanit, në një balancë negative nga shuma -1,543,294 lekë para rezultateve të hetimit në shumën -288,000 lekë, pas ndryshimeve.

**28.5** Trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>24</sup> në vlerësimin e balancave negative, çmon se mungesa e burimeve të ligjshme në shumën -288,000 lekë nuk e bën deklarimin e pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, sipas parimit të proporcionalitetit, pasi shuma e munguar për të mbuluar çmimin e blerjes së dyqanit përfaqëson një diferencë të vogël në raport me mundësitë financiare të familjes Strakosha.

**29. Pasuri e luajtshme automjet tip “\*\*\*\*”,** blerë në vitin 2002, me kontratën e shitjes datë 11.9.2002, nga shitësi B.M dhe blerësi A.S . Vlera: 1,100 euro. Pjesa takuese: 50 %.

**29.1 Si burim krijimi** të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat: (i) nga puna si ndihmëse gjyqtare për periudhën shkurt 1996 – maj 2000; (ii) puna si avokate për periudhën 2000 – 2005 (pjesërisht e regjistruar); (iii) puna e bashkëshortit si person fizik për periudhën 15.8.1994 – 30.4.1996; (iv) puna e bashkëshortit në emigracion deri në vitin 2000; (v) puna si inspektor SHIK-u në periudhën 2000 – 2004.

### **Deklarimi i pasurisë në deklaratat periodike**

**29.2** Referuar dy deklaratave të plotësuara nga subjekti për shkak të funksionit si kancelare, përkatësisht deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës datë 6.5.2010, si dhe asaj të largimit nga funksioni datë 18.10.2010, subjekti dhe bashkëshorti i saj si person i lidhur me detyrimin për deklarim kanë deklaruar: “*Makinë tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2002, vlera 380,000 lekë, pjesa takuese ½*”.

### **Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri**

**29.3** Pasaktësi lidhur me vlerën e automjetit tip “\*\*\*\*”, pasi në deklaratën para fillimit ka deklaruar 380,000 lekë, ndërsa në deklarimin *Vetting* ka deklaruar 1,100 euro.

<sup>23</sup> Shuma 959,000 lekë në Raiffeisen Bank dhe shuma 118,000 lekë pranë Alpha Bank nga e cila vërehet se një pjesë e shumës është bërë depozitë, ndërkohë shuma e tërhequr në total në të dyja bankat është 1,065,000 lekë.

<sup>24</sup> Referojuni qëndrimin të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin nr. 38/2021 (JR).

## Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**29.4** DPSHTRR-ja<sup>25</sup> konfirmon se bashkëshorti i subjektit, z. A.S , ka pasur në pronësi automjetin tip “\*\*\*\*” dhe ka dërguar dosjen lidhur me këtë automjet.

**29.4.1** Nga administrimi i dokumentacionit ka rezultuar se me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.11.2002, shtetasi B.M i ka shitur bashkëshortit të subjektit automjetin tip “\*\*\*\*”, tip 1200, ngjyrë e bardhë, kundrejt çmimit 1,100 euro, shumë e likuiduar nga blerësi. Vërehet se automjeti është blerë në Gjermani me kontratën e shitjes datë 11.9.2002<sup>26</sup>, në të njëjtën vlerë 1,100 euro, dhe në vijim është zhdoganuar nga shtetasi B.M , ku janë paguar edhe detyrimet tatimore.

**29.5** Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit se subjekti i rivlerësimit në mënyrë konsistente ka deklaruar në të dyja deklaratat e pasurisë për vitin 2010<sup>27</sup> si vlerë automjeti shumën 380,000 lekë. Nisur nga mospërputhja e deklarimeve lidhur me vlerën e automjetit, Komisioni e ka pyetur subjektin<sup>28</sup>, e cila ka shpjeguar<sup>29</sup> se vlera 380,000 lekë është shuma që ka shpenzuar për blerjen e këtij automjeti që përfshin çmimin e blerjes në vlerën 1,100 euro, e konvertuar në lekë në shumën 149.820 lekë dhe gjithë shpenzimet që lidhen me zhdoganimin e mjetit në shumën 148,000 lekë, referuar aktit të deklaratës doganore datë 21.11.2002, si dhe pagesat e tjera të nevojshme për përkthimin e dokumenteve gjermane dhe ato lidhur me redaktimin e kontratës së shitjes, si dhe të gjitha detyrimet e tjera ligjore që janë paguar pranë DPSHTRR Vlorë, duke paraqitur dokumentacion provues<sup>30</sup> të disponueshëm për këtë praktikë.

**29.6** Komisioni i administroi aktet e paraqitura nga subjekti, sipas të cilave mbështeten shpjegimet e subjektit dhe referuar këtyre akteve rezulton se bashkëshorti i subjektit, përveç çmimit të paguar për blerjen e automjetit në shumën 1,100 euro, ka kryer edhe pagesa të tjera të domosdoshme për të disponuar automjetin e blerë në Gjermani, në një total shpenzimesh prej 380,000 lekësh. Për rrjedhojë, shpenzimet e deklaruara nga subjekti u vlerësuan të pranueshme dhe janë përfshirë në analizën financiare për blerjen e automjetit.

### Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

**30.** Në lidhje me blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar se burim krijimi kanë qenë të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit, duke i specifikuar si vijon: (i) nga puna si ndihmëse gjyqtare për periudhën shkurt 1996 – maj 2000; (ii) puna si avokate për periudhën 2000 – 2005 (pjesërisht e regjistruar); (iii) puna e bashkëshortit si person fizik për periudhën 15.8.1994 – 30.4.1996; (iv) puna e bashkëshortit në emigracion deri në vitin 2000; (v) puna si inspektor i SHIK-u në periudhën 2000 – 2004.

**30.1** Komisioni ka hetuar në lidhje me këto të ardhura dhe i ka kërkuar gjithashtu subjektit të paraqesë dokumentacion provues<sup>31</sup>. Nga administrimi i dokumentacionit, në kuptim të hetimit, Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e deklaruara nga

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2024 dhe kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2024.

<sup>26</sup> Referohet data e vërtetimit të përkthimit.

<sup>27</sup> Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës datë 6.5.2010 të subjektit si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë, si dhe deklaratën e largimit nga funksioni datë 18.10.2010.

<sup>28</sup> Shihni pyetësorin 3.

<sup>29</sup> Shihni përgjigjen 1 të pyetësorit nr. 3, datë 17.4.2024.

<sup>30</sup> Akti deklarativ doganor datë 21.11.2002, kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., viti 2002, e noteres A.D. Kontratë shitjeje në gjuhën gjermane, faturë çregjistrimi në gjuhën gjermane, leje siguracioni në gjuhën gjermane, të përkthyer nga përkthyesi I. Dh.Z dhe deklaratën doganore.

<sup>31</sup> Në përgjigje të pyetësorit 3.

bashkëshortët Strakosha për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për periudhën 1996 – 2002.

**30.2** Nga analiza financiare e kryer duket se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 21.11.2002, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 721,469 lekë.

**30.3 Si konkluzion**, nga hetimi i Komisionit në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie dhe burimet e përdorura për blerjen e saj nuk u konstatuan problematika.

**31. Tokë ullishtë me sip. 600 m<sup>2</sup>**, me vlerë 300,000 lekë, ndodhur në Dh, Vlorë.

**32. Tokë pemëtoare me sip. 400 m<sup>2</sup>**, me vlerë 200,000 lekë, ndodhur në Dh, Vlorë.

**33. Tokë pemëtoare me sip. 1.400 m<sup>2</sup>**, me vlerë 700,000 lekë, ndodhur në Dh, Vlorë.

**34.** Referuar deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting*, të tria pasuritë janë përfituar me shitblerje, sipas kontratave përkatëse të shitblerjes datë 21.10.2005, me palë shitëse K. K dhe L. K dhe palë blerëse J.S , A.S , V.S, R.S , A.T (S) dhe P.S. Gjithashtu, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar secili se zotërojnë 1/16 pjesë takuese në këto pasuri.

**34.1 Si burim krijimi** të këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga këto burime: (i) *puna si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë për periudhën qershor 2005 – tetor 2010*; (ii) *puna si avokate për periudhën 2000 – 2005 (pjesërisht e regjistruar)*; (iii) *puna e bashkëshortit si inspektor i SHIK-u nga periudha 2000 – 2004*.

#### **Deklarimi i pasurisë në deklaratat periodike**

**35.** Referuar dy deklaratave të plotësuara nga subjekti për shkak të funksionit si kancelare, përkatësisht deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës datë 6.5.2010, si dhe deklaratës së largimit nga funksioni datë 18.10.2010, bashkëshorti i subjekti, z. A.S , si person që mbartte detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 9049/2003, ka deklaruar: *“Një truall me sip. 2400 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të blerë në vitin 2005 në Dh në vlerën 1,200,000 lekë, me pjesë takuese 1/6”*.

#### **Konkluzionet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri**

**36.** Ka pasaktësi lidhur me deklarimin e pjesës takuese të sipërfaqeve të mësipërme dhe konkretisht në deklaratën *Vetting*, deklaruar 1/16 pjesë, në deklaratën para fillimit të detyrës ka deklaruar 1/6 pjesë, ndërsa referuar kontratave të shitblerjeve rezulton se pjesa takuese e A.S është 1/8 pjesë.

**36.1** Vlerë e dyshimtë e blerjes së sipërfaqeve ullishtë 600 m<sup>2</sup>, pemë 400 m<sup>2</sup>, ullishtë 1.400 m<sup>2</sup>, me vlerë totale blerje 1,200,000 lekë, ose 500 lekë/ m<sup>2</sup>.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto pasuri**

**37.** Referuar akteve të administruara në dosjen e hetimit ka rezultuar se pasuritë bujqësore janë përfituar me kontratat e shitblerjes si vijon:

**37.1** Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.10.2005, shitësit K.K dhe L.K i shesin shtetasve J.S , A.S , V.S, R.S , A.T (S) dhe P. S tokë pemëtoare, me sip. 400 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “\*\*\*”, në fshatin Dh,Vlorë, kundrejt çmimit 200,000 lekë, i paguar plotësisht para hartimit të kontratës.

**37.1.1** Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.10.2005, shitësit K.K dhe L.K i shesin shtetasve J.S , A.S , V.S, R.S , A. T (S) dhe P.S tokë ullishte, me sip. 1400 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “\*\*\*”, në fshatin Dh, Vlorë, kundrejt çmimit 700,000 lekë, i paguar plotësisht para hartimit të kontratës.

**37.1.2** Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.10.2005, shitësit K.K dhe L.K i shesin shtetasve J.S , A.S , V.S, R.S , A.T (S) dhe P.S tokë ullishte, me sip. 600 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “\*\*\*”, në fshatin Dh, Vlorë, kundrejt çmimit 300,000 lekë, i paguar plotësisht para hartimit të kontratës.

**37.2** Pas regjistrimit të kontratave të shitblerjes, rezulton<sup>32</sup> se pasuritë figurojnë në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit bashkë me familjarët Strakosha, në të cilat disponon 1/8 pjesë takuese në secilën pasuri, por në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar 1/16 pjesë takuese, duke sqaruar<sup>33</sup> se vjen për shkak të regjimit pasuror martesor me bashkëshortin e saj.

### **Në lidhje me çmimin e shitblerjes së pasurive**

**38.** Referuar kontratave të shitblerjes, me anë të të cilave janë përfitur pasuritë bujqësore, vërehet një çmim prej 500 lekësh/m<sup>2</sup>, i cili në dukje duket preferencial.

**38.1** Komisioni iu drejtua Agjencisë së Trajtimit të Pronave<sup>34</sup> (në vijim referuar si “ATP”) për të marrë informacion në lidhje me çmimin e referencës së shitblerjeve të pasurive (pemëtore dhe ullishte) në fshatin Dh, që kanë aplikuar për vitin 2005.

**38.1.1** ATP-ja<sup>35</sup> informon Komisionin, ndër të tjera, se për periudhën 2005 – 2006 i janë referuar VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuar në hartat përkatëse për qarqet Fier, Elbasan, Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër”, për përcaktimin e vlerave referuese për metër katror të tokave bujqësore pemëtore dhe ullishte, në fshatin Dh, Bashkia Himarë.

**38.1.2** Në vijim, Komisioni administroi vendimin bashkëlidhur të cilit gjendet harta e vlerës për rrethin e Vlorës, ku vërehet se për fshatin Dh, toka bujqësore ka pasur vlerën 481.5 lekë për metër katror, pra afërsisht sa çmimi i blerjes, i përcaktuar në kontratë prej 500 lekësh për metër katror.

**38.2** Në kuptim të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, Komisioni e ka pyetur subjektin nëse ka pasur trajtim preferencial për blerjen e këtyre pasurive, si dhe i ka kërkuar asaj shpjegime në lidhje me marrëdhënien me këta shtetas, e cila ka shpjeguar<sup>36</sup> se nuk ka pasur trajtim preferencial për këtë çmim blerjeje, pasi çmimi i blerjes së këtyre pasurive prej 500 lekë për metër katror ka qenë afërsisht sa çmimi referencë që është aplikuar në vitin 2005, në fshatin Dh, duke referuar të njëjtën VKM që Komisioni e ka administruar gjatë hetimit.

<sup>32</sup> Sipas certifikatave për vërtetim pronësie datë 15.11.2005 dhe kartelave të pasurive të lëshuara për secilën pasuri (tokë pemëtore dhe ullishte) të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

<sup>33</sup> Pyetur gjatë hetimit të Komisionit.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2024, nga ATP.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2024.

<sup>36</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes 6 të pyetësorit 2.

**38.2.1** Subjekti, gjithashtu ka sqaruar se pala shitëse L dhe K.K janë përkatësisht, tezja dhe bashkëshorti i tezes së bashkëshortit të saj, me të cilët kanë pasur marrëdhënie shumë të mira familjare dhe aktualisht nuk jetojnë më. Për të provuar këtë lidhje familjare, subjekti paraqiti në cilësinë e provës certifikatë familjare të viteve 1950 – 1974, lëshuar në datën 27.1.2023 nga Zyra e Gjendjes Civile Himarë, ku rezulton se H.Gj (S), vjehrra e subjektit, dhe L.Gj (K) janë motra, si dhe një dokument të gjendjes familjare të shtetas L.K, shkëputur nga regjistri i gjendjes civile<sup>37</sup>, ku rezulton se<sup>38</sup> shtetasja L. K është bashkëshorte e shtetasit K.K.

**38.3** Nga hetimi i Komisionit dhe nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit nuk u konstatuan problematika në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të.

### **Lidhur me burimet e krijimit**

**39.** Referuar deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burime krijimi për blerjen e tri pasurive bujqësore: (i) të ardhurat nga puna si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë për periudhën qershor 2005 – tetor 2010; (ii) të ardhurat nga puna si avokate për periudhën 2000 – 2005 (pjesërisht e regjistruar); (iii) të ardhurat nga puna e bashkëshortit si inspektor i SHIK-ut në periudhën 2000 – 2004.

**39.1** Komisioni ka hetuar në lidhje me të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur, nga ku për periudhën e deklaruar nga subjekti (2000 – 21.10.2005) të ardhurat e ligjshme që janë deklaruar dhe mbi të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë evidentuar: (i) të ardhurat nga paga e subjektit si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë në shumën 440,563 lekë; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit si inspektor në shumën 1,124,511 lekë; (iii) të ardhurat nga shitja e një dyqani të ndodhur në Vlorë në vitin 2004, shumën 500,000 lekë<sup>39</sup>; (iv) të ardhurat nga aktiviteti privat si avokat i subjektit për periudhën 2000 – 2005 sipas konfirmimeve në organet tatimore.

**39.2** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, që përfshin të ardhurat e ligjshme nga viti 2000 deri në datën e shitblerjes së pasurive, shpenzimet e dokumentuara/deklaruara nga subjekti dhe investimet e kryera për periudhën 2000 – 21.10.2005, duket se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të investuar me burime të ligjshme në blerjen e tri pasurive bujqësore, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 886,703 lekë.

**40. Banesë private me sip. 150 m<sup>2</sup>**, në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*” nr. \*\*\*, Vlorë, e trashëguar nga prindërit Ll dhe S. Dh, e papjesëtuar, zotërues i 1/5.

### **Deklarimi i pasurisë në deklaratat periodike**

**40.1** Referuar dy deklaratave të plotësuara nga subjekti për shkak të funksionit si kancelare, përkatësisht deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës datë 6.5.2010, si dhe deklaratës së largimit nga funksioni datë 18.10.2010, ka deklaruar: “*Banesë private prej 150 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, e trashëguar. Zotëron: 1/5 pjesë takuese*”.

**40.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:** Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP Vlorë.

<sup>37</sup> Duket se është marrë nga regjistri i gjendjes civile, si e drejtë aksesi për shkak të funksionit.

<sup>38</sup> Verifikuar edhe nga Komisioni në aksesin që ka në regjistrin e gjendjes civile.

<sup>39</sup> Deklaruar nga subjekti në pyetësorin 2 dhe provuar me dokumentacion provues.

## Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**40.3** Me kontratën e shitjes<sup>40</sup> nr. \*\*\* rep., datë 20.3.1959, të Gjykatës Popullore të Rrethit Gjyqësor Vlorë, babai i subjektit, i ndjeri Ll.Dh , dhe vëllai i tij S.Dh kanë blerë nga shtetasit H.M dhe M.M në shumën 170,000 lekë një shtëpi private të përbërë nga dy dhoma e një korridor, si dhe 90 m<sup>2</sup> oborr, të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Vlorë, regjistruar në vijim në regjistrat e transkriptimeve të hipotekës me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, viti 1959.

**40.4** Më tej, rezulton se babai i subjektit ka ndërruar jetë<sup>41</sup> dhe në vijim është çelur dëshmia e trashëgimisë në datën 12.5.1994, me nr. \*\*\* rep<sup>42</sup>.

**40.5** Në datën 31.7.1996<sup>43</sup>, me kontratën e pjesëtimit vullnetar nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., është pjesëtuar pasuria midis vëllezërve, ku subjekti bashkë me nënën, znj. S.Dh , dhe katër motrat<sup>44</sup> e saj M.Dh , N.Dh (P), E.Dh (M) dhe E.Dh (J), kanë marrë pjesën takuese përkatëse në cilësinë e trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit Ll.Dh . Sipas kësaj kontrate, pasuria është ndarë në mënyrë të barabartë midis dy vëllezërve duke përfutur secili përkatësisht nga një dhomë, gjysmë korridori dhe sipërfaqe oborri prej 45 m<sup>2</sup>.

**40.6** Në vijim, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.8.1996, xhaxhai i subjektit S.Dh i shet pjesën e tij takuese në këtë pasuri trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Ll.Dh kundrejt çmimit 1,600,000 lekë, duke sjellë për pasojë kalimin e plotë të të drejtave të pronësisë mbi këtë pasuri në favor të subjektit, nënës dhe motrave të saj.

**40.7** Pas ndërrimit jetë të nënës së subjektit, banesa i ka kaluar me trashëgimi subjektit dhe motrave të saj, përkatësisht M.Dh , N.P (Dh ), E.M (Dh ) dhe V.J (Dh ), me nga 1/5 pjesë takuese<sup>45</sup>, aq sa është deklaruar nga subjekti. Nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri nuk u evidentuan problematika.

**41. Gjendje cash në shumën 860,000 lekë, zotëron 50%. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.**

**41.1** Gjatë hetimit, Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me arsyet e mosdeklarimit, e cila ka shpjeguar se ka qenë i paqëllimshëm dhe se burim krijimi për gjendjen *cash* kanë qenë të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga qiraja, duke paraqitur në cilësinë e provave kontratat përkatëse të qirave.

**41.2** Në lidhje me mosdeklarimin *cash*, Komisioni vëren se bazuar në nenin 4, pika 1/d e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar si dhe pikës 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive... nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjektet e rivlerësimit kanë pasur detyrimin të deklarojnë bashkë me gjendjen e likuiditetit jashtë sistemit bankar edhe burimet e krijimit, si dhe të dorëzojnë bashkë me deklaratën e rivlerësimit kalimtar edhe dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit. Por, bazuar në

<sup>40</sup> Depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit 3.

<sup>41</sup> Në datën 22.2.1994, sipas informacionit në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, pjesë e hetimit të Komisionit.

<sup>42</sup> Referuar të dhënave në kontratën e pjesëtimit vullnetar datë 31.7.1996.

<sup>43</sup> Përfaqësuar në këtë kontratë nga subjekti i rivlerësimit me prokurorin nr. \*\*\*, datë 31.7.1996.

<sup>44</sup> Konfirmuar gjendja e trungut familjar sipas certifikatës familjare për vitet 1950 – 1974, datë 5.4.2024, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

<sup>45</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes 5 të pyetësorit II dhe dokumentacionin e paraqitur.

parimin e objektivitetit, duke vlerësuar: (i) deklarin e subjektit në lidhje me sasinë e disponueshme jashtë sistemit bankar; (ii) gatishmërinë dhe sjelljen e saj gjatë procesit të hetimit për të paraqitur dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim krijimi; (iii) burimet e krijimit rezultuan lehtësisht të verifikueshme nga hetimi i Komisionit dhe se gjithashtu nuk u konstatuan të ardhura të tjera të padeklaruara më parë nga subjekti – vlerësohen bindëse shpjegimet e subjektit në lidhje me mos deklarimin e burimeve të krijimit.

**41.3** Bazuar në dokumentacionin e rezultuar nga hetimi, si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, në lidhje me mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* të rezultuar në datën e deklaratës *Vetting*, Komisioni përgatiti analizën financiare mbi bazën e të ardhurave të deklaruara dhe mbi të cilat rezultuan të jenë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Analiza financiare u përgatit për dy periudha, atë para detyrës si subjekt rivlerësimi për periudhën 1.1.1994 – 31.5.2015, ku subjekti dhe personi i lidhur rezultuan në pamundësi për të mbuluar me burime të ligjshme në shumën -1,365,146 dhe pas marrjes së detyrës për periudhën 1.6.2015 – 29.1.2017, ku subjekti dhe personi i lidhur rezultuan gjithashtu në pamundësi për të mbuluar me burime të ligjshme në shumën -611,337 lekë. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**41.4** Subjekti paraqiti shpjegimet dhe provat në lidhje me barrën e provës së kaluar për pamundësinë e gjendjes *cash* dhe rezultatit financiar, të cilat përmbledhen si vijon, duke qenë se i referohen të njëjtës periudhë para detyrës dhe pas marrjes së detyrës si subjekt rivlerësimi.

**41.4.1** Në lidhje me shpenzimet subjekti ka kërkuar zbritjen e shpenzimeve:

**i.** shpenzimet e udhëtimit në Venecia për të dhe familjarët Strakosha në datat 25 - 28 qershor 2015, duke paraqitur një kopje të një deklaratë datë 9.6.2024, të lëshuar nga motra e saj, znj N.P , para Noterit Publik, Pensilvani, SHBA në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të hotelit;

**ii.** shpenzimet për transferimin e shumës në Greqi tek shtetasi F /P .P datë 12.1.2015 në shumën 330,360 lekë, duke pretenduar se këta shtetas janë prindërit e kunatit të saj që jetojnë në Greqi dhe duke qenë të moshuar e të sëmurë, kunati, shtetasi L. P, i ka dërguar bashkëshortit të subjektit nëpërmjet një të treti një shumë në vlerën rreth 3,000 USD, për t'i transferuar në Greqi, me qëllim ndihmë financiare. Subjekti ka theksuar se shuma e transferuar nuk përfaqëson shpenzimet e saj dhe familjes së saj e, për këtë arsye, duhet të hiqet nga analiza financiare. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave: deklaratë noteriale para Noterit Publik, Pensilvani, SHBA, datë 7.6.2024 e kunatit, shtetasit L.P, i cili nëpërmjet vullnetit të tij ka konfirmuar rrethanat për kalimin e shumës sikurse shpjeguar nga subjekti, si dhe fotokopje të ekstraktit bankar lëshuar nga banka M&T, Filadelfia, në lidhje me likuiditet bankare për periudhën 1.10.2014 – 30.1.2015 (total 4 fletë).

**41.4.2** Në lidhje me të ardhurat ka kërkuar rivlerësimin e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i saj dhe bashkëshortit të saj si vijon:

**i.** Për subjektin ka kërkuar të rivlerësohen të ardhurat nga aktiviteti tregtar i saj si avokate gjatë viteve të ushtrimit, duke përfshirë vitin 2011 për të cilin pretendon se ka kryer aktivitet me fitim në shumën 300,000 lekë, viti 2013, ku pretendon se ka paguar taksën e biznesit të vogël në shumën 33,000 lekë dhe taksën vendore në shumën 48,000 lekë, si dhe për vitin 2013 duke pretenduar se pavarësisht se nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë nuk disponohen të dhëna



për këtë vit, ka paguar detyrimet në Bashki dhe sigurimet shoqërore e, për këto arsye, nuk duhet të penalizohet. Subjekti, në këtë pikë, ka kërkuar edhe rivlerësimin e marzhit të fitimit, referuar jurisprudencës së Kolegjit në lidhje me rastet e njëjta. Për të provuar ushtrimin e aktivitetit si avokate për këtë periudhë, subjekti paraqiti në cilësinë e provave 17 vendime gjyqësore.

**ii.** Për bashkëshortin e subjektit ka kërkuar të përfshihen në analizë të ardhurat nga aktiviteti tregtar i tij si avokat dhe përkthyes zyrtar i gjuhës greke pranë gjykatave të dy niveleve në Vlorë, në shumën 175,000 lekë si avokat dhe në shumën 148,800 lekë.

**41.4.3** Subjekti, gjithashtu ka kërkuar të përfshihen si të ardhura edhe shuma 700,000 lekë, sipas së cilës është përfituar nga kredia e motrës e marrë në shtator të vitit 2014, shumë të cilën ia ka dhënë subjektit për të shlyer pjesët takuese të blera në Dh në vitin 2014, në shumën 2,000 euro, e cila do të trajtohet në vijim.

**41.4.4** Subjekti ka konkluduar se nëse konsiderohen këto pretendime, situata financiare e saj do të ndryshojë në balancë pozitive për të përballuar kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të tjera me burime të ligjshme.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**41.5** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet, provat e paraqitura nga subjekti, si dhe i analizoi ato në raport me dokumentacionin, rezultuar nga hetimi i Komisionit vëren se:

#### **a) Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i subjektit si avokate**

**41.5.1** Referuar dokumentacionit të hetimit të Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit është regjistruar me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 10.1.2002, si person fizik me veprimtari “Aktivitete juridike-avokat” dhe është regjistruar në organin tatimor me NIPT \*\*\* në datën 3.6.2004.

**41.5.2** Nga administrimi i dokumentacionit: (a) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2024, nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2024, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë; (b) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2024, nga Bashkia Vlorë, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit; (c) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2024, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit; (ç) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, nga DRT Vlorë, administruar nga dosja e ILDKPKI-së – evidentohen disa të dhëna në lidhje me ushtrimin e aktivitetit si avokat nga subjekti që nga viti 2002 deri në vitin 2014.

**41.5.3** Referuar dokumentacionit të lëshuar nga organet tatimore në lidhje me situatën financiare të subjektit si person fizik, duket se subjekti ka rezultuar me fitim në vitet 2002, 2004, 2011, 2013 dhe 2014, të cilët janë konsideruar nga Komisioni në analizën financiare sipas informacionit të dërguar nga organet tatimore, përveç viteve 2004 dhe 2013, ku informacioni ka rezultuar i reduktuar.

**41.5.4** Për të evidentuar qarkullimin e mundshëm të realizuar nga subjekti për këto vite, në një vlerësim alternativ dhe sa më objektiv të të gjithë dokumentacionit dhe rrethanave të përfituara gjatë hetimit administrativ, Komisioni iu referua kuadrit ligjor të kohës mbi bazën e të cilit rregullohej aktiviteti tregtar i biznesit të vogël.

**41.5.5 Për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004**, referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, subjektet që ushtronin aktivitetin e profesioneve të lira (avokatit) kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën 30,000 lekë/vit<sup>46</sup>. Ndërsa, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar<sup>47</sup>, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën 4 për qind të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik. Referuar dokumenteve të administruara në dosje duket se, subjekti “A.S” person fizik, ka paguar shumën 30,000 lekë si taksë vendore mbi biznesin e vogël për vitin 2004 dhe shumën prej 17,500 lekësh tatim të thjeshtuar mbi fitimin, i cili i korrespondon 4% të qarkullimit të konfirmuar në shumën 437,500lekë<sup>48</sup>.

**41.5.6** Pra, nga analiza që i bëhet këtij kuadri ligjor në raport me faktet e hetimit, duket se për vitin 2004 subjekti tregtar “A.S”, person fizik, ka realizuar qarkullimin prej 437,500 lekësh xhiro, mbi të cilën provohet se janë paguar detyrimet tatimore. Mbi xhiron e përllogaritur, trupi gjykues vlerëson të arsyeshme aplikimin e marzhit të fitimit prej 80% për sa nuk disponohen të dhëna në lidhje me shpenzimet e kryera nga subjekti, qasje kjo e cila vjen në harmoni edhe me jurisprudencën e Kolegjit<sup>49</sup>. Për rrjedhojë, nga përllogaritja me këtë marzh fitimi, për vitin 2004 duket se subjekti ka rezultuar të ardhura në total në shumën 350,000 lekë.

**41.5.7 Për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013**, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, subjektet që ushtronin aktivitetin e profesioneve të lira (avokatit) në qytetin e Vlorës dhe të cilët kanë pasur një qarkullim/xhiro deri në 2,000,000 lekë kishin detyrimin për pagesën e taksës mbi biznesin e vogël në shumën 30,000 lekë/vit<sup>50</sup> të ndarë në 4 këste nga 7,500 lekë/secili. Referuar dokumenteve të administruara në dosje duket se subjekti “A.S”, person fizik, ka paguar në vitin 2013 shumën 33,000 lekë si taksë mbi biznesin e vogël dhe 3,400 lekë për taksa vendore. Pra, duket se për vitin 2013, subjekti tregtar “A.S”, person fizik, mund të ketë realizuar qarkullimin prej 2,000,000 lekësh, mbi të cilën provohet se janë paguar detyrimet tatimore, dhe pas përllogaritjes me marzhin e fitimit prej 80%, të ardhurat e rezultuara për vitin 2013 janë në total në shumën 1,600,000 lekë.

#### **b) Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit si avokat**

**41.5.8** Referuar dokumentacionit të hetimit të Komisionit rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.S, figuron i regjistruar në organin tatimor në datën 12.3.2010 me veprimtari “Aktivitete të drejtësisë” dhe çregjistruar në datën 23.12.2015. Nga administrimi i dokumentacionit në lidhje me aktivitetin e bashkëshortit të subjektit nuk konfirmohet të ketë pasur fitim. Për rrjedhojë, në analizën financiare nuk janë konsideruar të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit.

**41.5.9** Trupi gjykues, gjithashtu mori në shqyrtim pretendimet e subjektit në lidhje me zbritjen e shpenzimeve të pretenduara, nga ku vëren se nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti nuk provohet se pagesat janë kryer nga të tretët, për sa nuk ka gjurmë në sistemin bankar se të ardhurat me të cilat janë kryer pagesat e pretenduara i përkasin shtetasve përkatës,

<sup>46</sup> Sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur si Aneks i ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

<sup>47</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 9161., datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

<sup>48</sup> Referojuni dokumentit procesverbal – rakordimi i detyrimeve tatimore, datë 23.3.2005 (administruar në dosje).

<sup>49</sup> Referojuni vendimit të Kolegjit, nr. 12/2020 P. Gj.

<sup>50</sup> Sipas aneksit nr. 5, bashkëlidhur ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

në rastin konkret motrës dhe bashkëshortit të saj. Për rrjedhojë, pretendimi për zbritjen e shpenzimeve të përlogaritura nga Komisioni mbetet i paprovuar.

**41.5.10 Si konkluzion**, pas rivlerësimit të të ardhurave nga aktiviteti tregtar i subjektit të evidentuara me dokumentacion provues, balanca për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* deri në datën e deklaratës *Vetting* ndryshon nga negative në pozitive, respektivisht për dy periudha, para dhe pas marrjes së detyrës, duke prezumuar se gjendja *cash* përfaqëson kursimet e gjithë jetës të disponuara deri në datën e deklaratës *Vetting*. Për rrjedhojë, për periudhën para detyrës, 1994 – 31.5.2015 balanca nga -1,365,146 lekë ndryshon në 684,854 lekë dhe pas marrjes së detyrës, për periudhën 1.6.2015 – 29.1.2017 balanca nga -611,337 lekë ndryshon në 73,517 lekë, referuar tabelave financiare të pasqyruara më poshtë në këtë vendim në seksionin e analizës financiare. Trupi gjykues konkludon se subjekti ka pasur mundësi financiare për të përballuar me burime të ligjshme krijimin e gjendjes *cash* në shumën 860,000 lekë.

**41.6 Në lidhje me gjendjen e llogarisë së pagës pranë BKT-së**, në datën 26.1.2017, në shumën 30,757.93 lekë, konfirmohet nga hetimi administrativ<sup>51</sup> dhe nuk u konstatuan problematika.

## **PASURITË E DEKLARUARA NGA BASHKËSHORTI I SUBJEKTIT**

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të njëjtat pasuri me subjektin e rivlerësimit, duke shtuar pasurinë si vijon:

**42. Banesë private gjysmë e rrënuar me sip. 80 m<sup>2</sup>**, në fshatin Dh, e trashëguar dhe e papjesëtuar. Në bashkëpronësi.

**42.1** Nga hetimi i Komisionit, si dhe referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë hetimit, ka rezultuar se ASHK<sup>52</sup>, Drejtoria Vendore Vlorë informon se shtetasi A.S ka aplikuar për legalizimin e një objekti të ndërtuar në Dh, Bashkia Himarë, si dhe ka dërguar dosjen nr. \*\*\*/\*\*\*.

**42.2** Nga administrimi i akteve vihet re se gjyshi i bashkëshortit të subjektit, i ndjeri G.S, ka pasur në pronësi një truall, në vitet '50-'52, në Dh, me sip. 80 m<sup>2</sup>, sipas vërtetimit të Seksionit të Kadastrës<sup>53</sup>. Mbi këtë truall është ndërtuar një banesë, rreth vitit 1980, për të cilën bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, ka kërkuar të legalizohet.

**42.3** Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit, subjekti ka informuar Komisionin se pas deklarimit në deklaratën *Vetting* ka filluar procesit i menaxhimit të banesave në fshatin Dh dhe, për rrjedhojë, edhe banesa e G.S (gjyshi i bashkëshortit) iu nënshtrua procesit të menaxhimit përkatës. Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 18.5.2017, të Këshillit të Bashkisë Himarë "Për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri në vitin 10.8.1991 dhe truallit funksional të saj", është vendosur kalim në pronësi të objektit<sup>54</sup> ndërtesë me sip. 43.73 m<sup>2</sup> (dy kate) dhe truallit me sip. 133.96 m<sup>2</sup>. Pra, kjo banesë e deklaruar si 80 m<sup>2</sup>, pas matjeve faktike të kryera si rezultat i procesit të këtij menaxhimi, ka rezultuar me sip. 133.96 m<sup>2</sup>, nga këto 43.73 m<sup>2</sup> banesë, duke paraqitur edhe dokumentacion provues.

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2024.

<sup>52</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2021.

<sup>53</sup> Data është e pallexuar.

<sup>54</sup> Referuar një liste bashkëngjitur vendimit, ku në numrin rendor pasuror \*\*\* figurojnë trashëgimtarët e G.M.S.

**42.4** Komisioni administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, ku vihet re se referuar akteve të regjistrimit të pasurisë certifikatë regjistrimi datë 6.4.2021 dhe kartelë pasurie datë 29.4.2021, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, pasuria objekt vlerësimi, truell me sip. 133.96 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 43.73 m<sup>2</sup>, figuron e regjistruar në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe trashëgimtarëve të tjerë me zëvendësim të të ndjerit G.S (gjyshi i bashkëshortit).

**42.5** Gjatë hetimit administrativ është evidentuar një transaksion i kryer në datën 17.9.2014, në llogarinë e subjektit pranë Raiffeisen Bank, nëpërmjet mënyrës depozitim *cash* në vlerën 700,000 me përshkrimin “M.Dh likuidim detyrimi brenda familjes motra e klientes”.

**42.6** Nisur nga ky transaksion, subjekti është pyetur në lidhje me qëllimin e transferimit të këtyre fondeve, e cila ka sqaruar<sup>55</sup> se qëllimi i këtij transaksioni ka qenë për blerjen e pjesëve takuese të katër bashkëpronarëve/bashkëtrashëgimtarëve në bashkëpronësinë që kishin në banesën e trashëguar në Dh. Për realizimin e këtij qëllimi, subjekti ka sqaruar se i ka kërkuar motrës së saj, shtetas M.Dh , të merrte një kredi në vlerën 700,000 lekë, pasi ajo e merrte më shpejt, për shkak të marrëdhënieve të punës me shtetin. Pasi janë përfunduar procedurat e aprovimit të kredisë, motra e saj ia ka kaluar subjektit këtë shumë. Ajo ka sqaruar më tej se me kalimin e kësaj shume janë realizuar vetëm dy blerje të pjesëve takuese të bashkëpronësisë së bashkëpronarëve, konkretisht nga shtetasit Y.B dhe V.B , ndërkohë që dy bashkëpronarët e tjerë janë tërhequr. Subjekti ka sqaruar se shumën e lekëve të përdorur ia ka kthyer motrës M.Dh . Për të mbështetur deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave: kontratë kredie bankare të datës 11.9.2014 lidhur midis kredihënësit Raiffeisen Bank dhe znj. M.Dh , në cilësinë e kredimarrëses, dhe dy kontrata noteriale<sup>56</sup> premtim-shitje lidhur midis shitësve të ardhshëm, përkatësisht Y dhe V.B dhe blerësit të ardhshëm A.S .

**42.7** Komisioni i administroi këto akte dhe vëren se sipas kontratës premtim-shitje datë 5.9.2014, të lidhur midis shtetasve Y.B dhe A.S dhe kontratë premtim-shitje datë 10.9.2014 lidhur midis shtetasve V.B dhe A.S , shtetasit B, trashëgimtarë të pasurisë, marrin përsipër detyrimin për shitjen e 1/28 pjesë takuese përkatëse në këtë pasuri bashkëshortit të subjektit, kundrejt çmimit 1,000 euro për secilën pjesë takuese, pra në total shuma 2,000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale nga bashkëshorti i subjektit. Sipas kësaj kontrate, kalimi i pronësisë mbi pasurinë do të bëhet me përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurisë. Vërehet<sup>57</sup> se me regjistrimin e pasurisë është lidhur kontrata noteriale<sup>58</sup> e shitjes së pasurisë së paluajtshme datë 22.5.2021 midis shitësve të lartpërmendur dhe bashkëshortit të subjektit.

---

<sup>55</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes 2 të pyetësorit V.

<sup>56</sup> Kontratë premtim-shitje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.9.2014, lidhur midis Y. B dhe A.S dhe kontratë premtim-shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.9.2014, lidhur midis shtetasve V.B dhe A.S.

<sup>57</sup> Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në pyetësorin e parë protokolluar me nr. \*\*\* , datë 23.9.2022.

<sup>58</sup> Me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

**42.8** Më tej, nga administrimi i aktit kontratë kredie datë 11.9.2014, e lidhur nga motra e subjektit, vërehet se kredia për të cilën subjekti deklaroi se ka shërbyer për pagimin e çmimit të blerjes së pjesëve takuese, i përket një date të mëvonshme nga data e kontratave premtim-shitje, në të cilat përcaktohej se çmimi ishte paguar. Për rrjedhojë, Komisioni nuk e konsideroi kredinë si burim të ardhurash për blerjen e pjesëve përkatëse të kësaj pasurie.

**42.9** Pas analizës së kryer, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar në lidhje me pamundësinë në shumën -1,601,546 lekë, për të blerë në datën 10.9.2014 dy pjesë takuese në këtë pasuri, si dhe të paraqesë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e mënyrës së përfitimit nëpërmjet shitblerjes së pjesëve takuese mbi këtë pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**43.** Subjekti ka theksuar edhe në shpjegimet përfundimtare se pjesët takuese në këtë pasuri janë blerë me kredinë e marrë nga motra, pavarësisht se rezulton se kredia është marrë më vonë, e për këtë ka paraqitur në cilësinë e provës nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, sipas së cilës vërehet se shuma është tërhequr në datën 19.9.2014. Subjekti ka shpjeguar se i ka kërkuar mirëkuptim shitësve për pagesën e çmimit, pasi ata ishin të afërmit e familjes Strakosha dhe se e ka të pamundur ta provojë aktualisht, pasi njëri nga bashkëpronarët ka ndërruar jetë, ndërsa tjetri është i sëmurë në Itali, duke paraqitur në cilësinë e provës një certifikatë vdekjeje, datë 7.6.2024, të shtetasit V.B .

**43.1** Në shpjegimet e saj, subjekti ka ndaluar edhe tek fakti i mosdeklarimit të mënyrës së përfitimit të dy pjesëve takuese nëpërmjet shitblerjes, duke sqaruar se mosdeklarimi ka qenë i paqëllimshëm dhe se e ka korrigjuar atë gjatë hetimit kur është pyetur nga Komisioni.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**44.** Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vëren se:

**44.1** Në lidhje me pretendimin për të përfshirë kredinë e marrë nga e motra e subjektit si burim krijimi për blerjen e dy pjesëve takuese të pasurisë, ky pretendim nuk mbështetet në dokumentacion provues, pasi pavarësisht se subjekti u përpoq të shpjegonte rendin e veprimeve të kryera për këtë transaksion me pëlqimin e shitësve, nga kontrata e shitblerjes, e cila ka fuqinë e ligjit për palët, rezultoi se çmimi ishte paguar përpara disbursimit të kredisë.

**44.2** Gjithsesi, për efekt të rezultatit financiar, nga rivlerësimi që i është bërë të ardhurave të subjektit nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë e, konkretisht, nga përfshirja në vitin 2013 të të ardhurave të përfituara në shumën 1,600,000 lekë, balanca për mundësinë e blerjes së dy pjesëve takuese të pasurisë, nga shuma -1,601,546 lekë para rezultatit të hetimeve, bëhet pozitive.

**44.3** Trupi gjykues, në lidhje me mosdeklarimin nga subjekti të mënyrës së përfitimit të dy pjesëve shtesë takuese nëpërmjet shitblerjes, vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, pasi bashkëshorti e ka deklaruar kryesisht këtë pasuri të përfituar me trashëgimi ligjore dhe se nga hetimi u provua ndryshimi i pjesëve takuese mbi të, për shkak të kontratës së shitblerjes.

## **ÇËSHTJE TË TJERA**

### **45. Në lidhje me një borxh, dhënë motrës së subjektit, znj. N.P, në vlerën 3,000,000 lekë**

**45.1** Referuar deklaratave të pasurisë së vitit 2010, është konstatuar se subjekti ka deklaruar: *“Dhënë borxh motrës një shumë të hollash në vitin 2007, në shumën 3,000,000 lekë”*. Ndërkohë në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka kryer deklaram në lidhje me këtë borxh.

**45.2** Subjekti gjatë hetimit sqaroi në lidhje me qëllimin e këtij borxhi, dhënë motrës së saj për ndihmë financiare, burimet e krijimit, si dhe kthimin e këtij borxhi brenda vitit 2013, duke u pasqyruar përkatësisht, në seksionin e të ardhurave në analizën financiare. Në lidhje me këtë borxh nuk u konstatuan problematika.

### **46. Në lidhje me deklaratimet e subjektit si kancelare për efekt të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin e pasurive”, i ndryshuar**

**46.1** Nga hetimi i Komisionit është konstatuar se subjekti ka kryer dy deklarime si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë në vitin 2010, përkatësisht sipas deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës datë 6.5.2010, si dhe në deklaratën e largimit nga funksioni datë 18.10.2010.

**46.2** Në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar, neni 3 paragrafi 1, përcaktohen subjektet që kanë detyrimin e deklarinimit, për efekt të ligjit. Referuar këtij neni, në kategoritë e subjekteve sipas shkronjës “gj” përfshiheshin edhe *zyrtarët që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta*. Referuar ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 2 e tij, parashikohej se: *“Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Drejtësisë”*. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti ka ushtruar detyrën si kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë për periudhën 1.6.2005 – 4.10.2010. Bazuar në faktet e rezultuara nga hetimi, si dhe në kuadrin ligjor sa më lart, duket se subjekti ka pasur detyrimin e deklarinimit të pasurive si kancelare të paktën që nga viti 2008 (me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9877/2008).

**46.3** Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti shpjegoi gjatë hetimit dhe në përfundim të tij se në dijeninë e saj nuk ka pasur detyrim deklarinimi, pasi kancelarët nuk ishin të përfshirë në rrethin e subjekteve deklaruese dhe se plotësimin e deklaratës së vetme të vitit 2010 e ka kryer pasi i është vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja. Subjekti ka konkluduar se nëse do të kishte qenë në shkelje të ligjit, do të kishte pasur një moment që ky autoritet t’ia bënte me dije e, për rrjedhojë, do të zbatoheshin sanksionet përkatëse.

**46.4** Në lidhje me këtë çështje, trupi gjykues çmon se plotësimi i deklaratave vjetore të subjektit si kancelare do të mund të ndihmonte Komisionin në procesin e vlerësimit të pasurive të krijuara para detyrës si subjekt rivlerësimi, por nuk e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi nga mosdeklarimi sipas ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive”, pasi kompetent për zbatimin e këtij ligji është institucioni i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

### **47. Analiza financiare për periudhat 1994 – 31.5.2015 dhe 1.6.2015 – 29.1.2017**

**47.1** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit

administrativ, Komisioni përgatiti analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për periudhën para detyrës v. 1994 – 31.5.2015, si dhe për periudhën 1.6.2015 – 29.1.2017 pas detyrës si subjekt rivlerësimi.

**47.2** Referuar analizës së kryer duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën 1994 – 31.05.2015, duke rezultuar me balancë negative në shumën – 1,365,146 lekë, si dhe për periudhën 1.6.2015 – 29.1.2017, duke rezultuar me balancë negative në shumën -611,337 lekë.

**47.3** Pas kalimit të barrës së provës dhe vlerësimit të shpjegimeve, si dhe provave të paraqitura nga subjekti, të arsyetuara në seksionin e pasurisë *cash*, rezultati financiar ndryshoi nga negativ në pozitiv, përkatësisht për periudhën 1994 – 31.5.2015 rezultati financiar është në shumën 684,854 lekë dhe për periudhën 1.6.2015 – 29.1.2017 rezultati financiar është në shumën 73,517 lekë, sipas tabelave vijuese.

**Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën para fillimit të detyrës 1994 – 31.5.2015**

	<b>1994 – 31.5.2015</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>3,380,253</b>
Dyqan me sip. 31,2 m <sup>2</sup> , në lagjen “****”, Vlorë	2,460,000
Tokë ullishte me sip. 600 m <sup>2</sup> , në Dh, Vlorë	37,500
Tokë pemëtore me sip. 400 m <sup>2</sup> , në Dh, Vlorë	25,000
Tokë ullishte me sip. 1,400 m <sup>2</sup> , në Dh, Vlorë	87,500
Banesë private me sip. 150 m <sup>2</sup> në lagjen “****”, Vlorë	-
Banesë private gjysmë e rrënuar me sip. 80 m <sup>2</sup> , në Dh, Vlorë	279,440
Automjet tip “****”, targë VL ***, blerë në vitin 2002.	380,000
Ndryshim likuiditeti 1994 – 31.5.2015	110,813
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
	-
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>3,380,253</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>14,610,964</b>
Të ardhura nga paga e S.R.	8,014,884
Të ardhura nga aktiviteti privat p. fizik e S.R.	3,021,304
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1,897,669
Të ardhura nga aktiviteti privat p. fizik, bashkëshorti i S.R.	-
Të ardhura nga qiraja e dyqanit me sip. 33 m <sup>2</sup> , ndodhur në Vlorë	105,000
Të ardhura nga shitja e dyqanit të ndodhur në Vlorë në vitin 2004	500,000
Të ardhura nga emigracioni/përkthyes	-
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat pranë Raiffeisen Bank	65,764

Të ardhura nga interesat e depozitës me afat pranë Alpha Bank	6,343
Të ardhura nga kthimi i huas nga shtetasja N.P	1,000,000
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>10,545,857</b>
Shpenzime jetike	6,120,126
Shpenzime për dhënie borxh ndaj motrës së subjektit N.P në shumën 3,000,000 lekë.	3,000,000
Shpenzime për transferimin e shumës në Greqi tek F/P.P 12.1.2015	330,360
Shpenzime udhëtime jashtë vendit	1,095,371
<b>F) Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>684,854</b>

**Tabela nr. 2 – Analiza financiare për periudhën pas fillimit të detyrës 1.6.2015 – 29.1.2017**

	<b>1.6.2015 – 29.1.2017</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>1,006,728</b>
Ndryshim likuiditeti 1.6.2015 - 29.1.2017	1,006,728
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>1,006,728</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>2,568,962</b>
Të ardhura nga paga e S. R.	1,180,146
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	591,962
Të ardhura nga qiraja e dyqanit 33 m <sup>2</sup> , ndodhur në Vlorë	112,000
Kursimet e realizuara para fillimit të detyrës	684,854
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>1,488,717</b>
Shpenzime jetike	1,156,532
Shpenzime për qiranë e apartamentit në zonën e unazës së re në Tiranë	180,000
Shpenzime udhëtime jashtë vendit	152,185
<b>F) Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>73,517</b>

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit pasuror**

**48.** Trupi gjykues, në përfundim, çmon se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi ose në përdorim.

**48.1** Në lidhje me balancën negative në shumën -288,000 lekë të rezultuar nga analiza financiare për blerjen e dyqanit në datën 29.3.2012, trupi gjykues çmon se kjo balancë në vetvete nuk është e mjaftueshme që të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit.

**48.2** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.



## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**49.** AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ajo ka apo ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**49.1** Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017.

**49.2** Në vijim, në kuadër të hetimit Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së<sup>59</sup> përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

**49.3** AKSIK-ja ka dërguar raportin për kontrollin e figurës të përditësuar dhe të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.7.2023, të KDZH-së, sipas të cilit konstatohet se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**49.4** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha.*

**50.** Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**50.1** Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën *indicie* apo elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**51.** Në përfundim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

**51.1.** Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**51.2** Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2023.

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**52.** Bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndihmësit ligjor vlerësohen në kuptim të kriterit profesional, bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- b) rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

### A) Vlerësimi i aftësive profesionale nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

**52.1** Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në procedurat për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 ka përgatitur Aktin “Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha<sup>60</sup>”.

**52.2** Raporti është përgatitur mbi bazën e tri dokumenteve ligjore<sup>61</sup> të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dokumenteve ligjore<sup>62</sup> të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**52.3** Referuar raportit është vlerësuar se: (i) subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha ka njohuri ligjore që manifestohen përmes projektvendimeve të përpunuara prej saj; (ii) nga analizimi i akteve vërehet se subjekti jep propozim konkret për gjyqtarin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, të cilat janë gjetur të pranueshme në vendimet e dhëna nga gjyqtarët; (iii) subjekti ka aftësi të mira organizative për të përballuar ngarkesën e lartë të punës, si dhe ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtarët asistues; (iv) nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha, por edhe nga dokumentet e shortuara, konstatohet se nuk kanë dalë *indicie* negative në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### B) Vlerësimi i aftësive profesionale nga Shkolla e Magjistraturës

**52.4** Bazuar në pikën 4 të nenit 179<sup>63</sup> të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 42<sup>64</sup> të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar vlerësimit profesional të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës.

---

<sup>60</sup> Me nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2023.

<sup>61</sup> Dokumenti 1. Si dokument 1 referohet projekt-vendimi nr. \*\*\*, datë 7.6.2016, mbi çështjen administrative me nr. \*\*\* akti. Dokumenti 2. Si dokument 2 referohet projektvendimi nr. \*\*\*, datë 4.3.2016. Dokumenti 3. Si dokument 3 referohet projektvendimi nr. \*\*\*, datë 27.6.2016.

<sup>62</sup> Dokumenti 4 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 7.6.2016, me gjyqtar G.M ; Dokumenti 5 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 9.12.2015, me gjyqtar G.M ; Dokumenti 6 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 25.4.2016, me gjyqtar G.M ; Dokumenti 7 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 2.6.2015, me gjyqtare G.M ;

Dokumenti 8 – Çështja administrative nr. \*\*\* akti, datë regjistrimi 25.6.2015<sup>62</sup>, me gjyqtare G.M .

<sup>63</sup> Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

<sup>64</sup> Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; (b) rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

**52.5** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës nr. \*\*\*, datë 21.5.2018, “Për miratimin e rezultateve të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*”, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj 2018.

**52.6** Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “testi elektronik<sup>65</sup>”, subjekti është vlerësuar me 53 pikë nga 100 pikë në total, ndërsa në fazën e dytë “testi profesional” subjekti është vlerësuar me 120 pikë nga 200 pikë në total.

**53.** Komisioni verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer për kryerjen e vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit dhe nga analizimi i të cilit Komisioni nuk evidentoi gjetje apo *indicie* në kuptim të kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

**53.1** Gjithashtu, si burim për rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit shërbejnë edhe denoncimet e publikut. Nga verifikimi i regjistrimit të denoncimeve të Komisionit nuk u evidentuan denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit.

#### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**54.** Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, akteve mbi të cilat është konkluduar raporti, rezultateve të testimit të kryer pranë Shkollës së Magjistraturës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Aneta Strakosha ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

---

<sup>65</sup> Referuar pikës 2 të nenit 22 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aneta Strakosha, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 14.6.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Pamela QIRKO**  
**Relatore**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*